



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

Projekt i USAID për shoqëri civile

Konkurs për dhënie e granteve të vogla

Për bursa pune në organizatat qytetare

Afati i fundit për dorëzim: 6 nëntor 2013, ora 16:00

HYRJE

Projekti i USAID për shoqëri civile (Projekti) do të siguron përkrahje për shoqërinë qytetare për iniciimin e reformave demokratike. Ky projekt është dizajnuar të kontribuon drejt tejkalimit të dobësive të organizatave qytetare, duke i përfshirë edhe pengesat e tyre në sigurimin e përkrahësve lokal, mungesën e koalicioneve efektive të cilat mundet ti përforcojnë pozitën e tyre dhe pamundësinë e tyre të merren me zgjidhjen e çështjeve që paraqesin sfida. Kjo do të arrihet nëpërmjet: 1) rritjes së përkrahjes së qytetarëve dhe iniciimin e aktivizmit qytetar dhe pjesëmarrjes; 2) zhvillimi i organizatave qytetare me qëllim të implementimit të mbikëqyrjes së pushtetit dhe përfaqësimit të politikave publike; dhe 3) vendosja e rrjeteve dhe platformave për mobilizim më të madh, bashkëpunim dhe solidaritet mes organizatave qytetare.

Projekti është mundësuar me përkrahjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID). Projektin e zbaton Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni (FShHM) në partneritet me katër organizata qytetare lokale: Forumin Rinor Arsimor, Forum – Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentim, Qendra për Komunikim Qytetar dhe Reaktor – Hulumtimi në Veprim.

FShHM e shpall këtë Konkurs për tu mundësuar hulumtuesve të interesuar dhe aktivistëve të punojnë në projekte aktuale hulumtuese në organizata qytetare duke dhënë **grante të vogla për bursa pune**.

KARAKTERISTIKAT E GRANTEVE

Me këtë Konkurs do të ndahen grante nga komponenti 2) *Mbikëqyrje dhe përfaqësim* të organizatave qytetare të cilët zbatojnë projekte hulumtuese. Aktivitetet nga ky komponent i Projektit të USAID për shoqëri civile kanë për qëllim ta stimulojnë shoqërinë civile për iniciimin e reformave demokratike.

Ky lloj i granteve do të siguron përkrahje për hulumtuesit dhe aktivistët qytetarë të kyçen prej 3 deri 6 muaj në organizata qytetare në Maqedoni gjatë vitit 2014. Grantet do tu ndahen organizatave qytetare (në shumë prej 2.400 dollarë amerikan) për harxhime që kanë të bëjnë me bursistët (rrogë apo honorar në bruto shumë prej 150 deri 300 dollarë amerikan në muaj) dhe harxhime operative për përgatitjen e dokumentit për politikë publike (me këtë grant nuk do të përkrahen honorarë plotësuese). Bursa e punës patjetër duhet të realizohet në tërësi në organizatën nikoqirë.

Bursistët mundet të jenë në çdo fazë të karrierës së tyre – nga studentë universitar deri te hulumtues; nuk duhet të jenë më të moshuar se 35 vjet. Kandidatët e interesuar patjetër duhet të dominohen nga ana e organizatës nikoqir, pasi që paraprakisht të kenë zgjedhur organizatë e cila sipas përvojës dhe interesit së tyre është adekuate.

Programi për bursa do të kontribuon për zhvillim institucional të organizatave qytetare dhe do të inicion bashkëpunim mes hulumtuesve të rinj dhe organizatave qytetare. Hulumtuesit më të rinj do të fitojnë mësim praktik dhe aftësi për mbikëqyrje të pushtetit dhe për përpunimin e dokumenteve inovative dhe kualitative për politika nëpërmjet mësimin nëpërmjet punës. Në organizatën nikoqir pritët që bursistët të angazhohen gjatë projektit aktual hulumtues dhe të zhvillojnë dokument konkret për politikë. Projektet hulumtuese duhet të përfshijnë një nga fushat në vijim: Kuvend, sundimi i së drejtës, gjyqësi, medime, harxhimi i parave publike, financimi i partive politike, politika që kanë të bëjnë me shoqërinë civile, politika rinore, barazi gjinore, përputhja e politikave të Bashkimit Evropian dhe absorbimi i fondeve të BE-s. Gjatë programit pune e bursistit duhet të udhëhiqet nga analist/mentor.

Nga bursistët dhe organizatat nikoqire pritet që jo vetëm publikisht ti shpallin rezultatet e punës së bursistëve por edhe ti shfrytëzojnë në mënyra në të cilat ato do të bëhen të rëndësishme dhe të qasshme për spektër të gjerë të shfrytëzuesve. Ata do tu mundësojnë qytetarëve, aktivistëve dhe përfaqësuesve ti shfrytëzojnë të dhënat ekzistuese për zhvillimin e argumenteve të bazuara në dëshmi për ndryshimin e politikave publike.

Rezultatet e punës së bursistëve mund të jenë analizë e bazuar në hulumtim për zgjerimin e informimit të publikut për opsionet në politikat publike, dokument për përmirësimin e politikave publike të bazuar në hulumtim apo ngjashëm.

Këto grante duhet të kontribuojnë për arritjen e qëllimit të dytë të Projektit: *Zhvillimi i organizatave qytetare për mbikëqyrjen e pushteteve dhe përfaqësimin e politikave publike.*

NDIHMË TEKNIKE

FShHM do të siguron për bursistët trajnim për hulumtim për politika dhe do të përkrah përkrahjen e rrjetit të bursistëve nëpërmjet ngjarjeve të përbashkëta vjetore.

Pas dhënies së granteve, FShHM do ta ndjek zbatimin e projekteve dhe do të siguron ndihmë teknike (trajnime dhe konsultime) për të gjithë grantistët, në bazë të niveleve konkrete të kompetencave.

Ndihma teknike do të sigurohet nëpërmjet trajnimeve të specializuara për zhvillimin e kapaciteteve dhe si përgjigje e nevojave konkrete të grantistëve, duke përfshirë trajnime për menaxhim financiar dhe dorëzimin e raporteve, marrëdhënie me publikun, zhvillim organizativ, monitorim dhe vlerësim, etj. Grantistët dhe organizatat tjera qytetare do të trajnohen për shkrimin e dokumenteve për politika publike, hulumtime dhe mbikëqyrje të pushtetit, përfaqësim dhe trajnime tematike (procesi i anëtarësimit në BE, harxhimi i parave publike, decentralizimi dhe ndarja e kompetencave).

Do të sigurohet edhe përkrahje e grantistëve për përpilimin dhe implementimin e strategjive për përfaqësim dhe komunikim. Do të organizohen takime për lidhje të ndërsjellë të grantistëve dhe për shpërndarjen e informatave, përvojave dhe leksioneve të mësuara, diskutime për probleme aktuale, mënyra të mundshme për zgjidhjen e tyre, si dhe për mundësitë për bashkëpunim mes organizatave qytetare në zgjidhjen e çështjeve të interesit të përbashkët.

PROCESI I VLERËSIMIT

Me këtë konkurs do të përkrahen propozim projekte të cilët janë inovativ dhe do të arrijnë ndikim të dukshëm dhe të cilët:

- a) në mënyrë të drejtpërdrejtë i përkrah qëllimet e Projektit të USAID për shoqëri civile;
- b) ofrojnë strategji kreative dhe efektive për qasje deri te informata dhe për kontribut drejt politikave;
- c) promovojnë qasje integruese me fokus të etnikumit dhe gjinisë;
- d) përpunohen çështje të rënda reformatore.

Prioritet do tu jepet iniciativave kreative dhe racionale të cilat premtojnë qëndrueshmëri në afat të gjatë.

Zgjedhja e grantistëve është proces i cili do të zhvillohet në tre faza: vlerësim fillestar, vlerësim dhe miratim. Secili aplikacion do të vlerësohet fillimisht për të garantuar se i plotëson kërkesat themelore dhe se është në pajtim me kriteret për kualifikim, të cilët janë:

- Formulari për paraqitje dhe shtojcat të përdoren dhe të dorëzohen;
- Aplikacioni të jetë tërësisht i plotësuar dhe ti përfshinë shtojcat e nevojshme;
- Aplikacioni duhet të dorëzohet para mbarimit të afatit përfundimtar;
- Aplikacioni nuk duhet të jetë i shkruar me dorë;
- Përkrahja e kërkuar financiare mos ta tejkaloj shumën maksimale të grantit të dhënë në këtë konkurs;
- Aplikacioni mos të dorëzohet nga parti politike, organizatë fitimprurëse apo organizatë qytetare e cila promovon dhe shfrytëzon dhunë.

Aplikacionet duhet të jetë në pajtim me të gjitha kriteret me qëllim që të kalon në fazën e vlerësimit. Formularët të cilët nuk i plotësojnë këto kushte dot refuzohen.

Të gjithë aplikacionet e vlerësuar pozitivisht në fazën e vlerësimit fillestar do të prezantohen para Komitetit për seleksionim i cili pastaj do ti miraton/refuzon/miratton me kusht. Komiteti për seleksionim do ti vlerëson aplikacionet në bazë të kritereve në vijim:

1. Angazhimi i bursistit (maksimum 60 pikë)
 - o Rëndësia e nevojave dhe çështjeve të përfshira në hulumtim (20 pikë)
 - o Rezultate të pritura (20 pikë)
 - o Të dhënat biografike dhe potenciali i bursistit (20 pikë)
2. Kapaciteti dhe përvoja e organizatave (maksimum 30 pikë)
 - o Kapaciteti për menaxhim dhe mentorim (15 pikë)
 - o Përvoja relevante dhe rezultate në fusha të ngjashme (15 pikë)
3. Propozim buxheti (maksimum 10 pikë)
 - o Arsyetimi i buxhetit (10 pikë)

Gjatë procesit të vlerësimit, FShHM mundet të kërkon informata plotësuese nga ai që aplikon në lidhje me propozim projektin apo për vetë organizatën, të cilat mendon se janë të nevojshme për përfundimin e vlerësimit. Kërkimi i informatave plotësuese nuk nënkupton se FShHM do ta përkrah propozim projektin. Para miratimit të grantit, FShHM mundet ti viziton organizatat e paraqitura.

Deri te organizatat e paraqitura në konkurs do të dërgohen letra për miratim, refuzim apo miratim me kusht të propozim projekteve. Organizatat propozim projektet e të cilave do të miratohen do të marrin Kontratë për grant në të cilën janë paraparë obligimet ligjore të organizatës – fituese e grantit.

DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Secili propozim projekt duhet të dorëzohet në **formularin për aplikim në Projektin e USAID për bursa pune**, duke e përfshirë **formularin për buxhet** dhe gjitha shtojcat e duhura. Formulari për aplikim duhet të plotësohet tërësisht dhe ai nuk duhet të tejkalon 6 faqe (pa buxhet dhe shtojca).

Shtojcat e nevojshme:

1. Kopje e dokumenteve për regjistrim (nga Regjistri Qendrorë i RM-s);
2. Raport vjetor narrativ dhe financiar i organizatës nikoqir nga viti paraprak;
3. Hulumtimi i fundit i organizatës nikoqir;
4. Biografite e kandidatit dhe mentorit (maksimum dy faqe për çdo biografi);
5. Deklaratë e kandidatit për pjesëmarrje në programin për bursa pune;
6. Korniza kohore për angazhimin e bursistit (në formatin e dhënë: Shtojca 1);

Aplikacionet e kompletuara duhet të dorëzohen në dy kopje të printuara në gjuhën angleze në A4 format. Së bashku me dokumentet duhet të dorëzohet edhe CD me versioni elektronik të gjitha dokumenteve. Versioni i printuar dhe elektronik i dokumenteve duhet të jetë identik.

Aplikacioni i kompletuar patjetër duhet të dorëzohet në një zarf të titulluar „Konkurs për dhënien e granteve të vogla për bursa pune” dhe emri i organizatës.

Propozimet duhet dërguar nëpërmjet postës apo të dorëzohen në dorë në adresën më poshtë. Për aplikacionet e dërguara me postë si kohë e dorëzimit do të merret koha e aritjes në adresën e FShHM dhe JO koha e dorëzimit në postë. Aplikacionet patjetër duhet të arrijnë në FShHM deri në ora 16.00 më 6 nëntor 2013. Aplikacionet e pranuar pas këtij afati nuk dot shqyrtohen.

Materialet për aplikim mund të merren në: www.soros.org.mk www.civilsociety.mk.

Në qytete do të mbahen sesione lokale informative. Orari i këtyre sesioneve do të shpallet plotësisht.

Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni
Bul. Jane Sandanski 111
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë